



**INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO**  
**INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS**  
**INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA**

## **RAPORTI VJETOR 2015**



Adresa:  
Fshati Sfaracak i Ulët, p.n  
42000 Vushtrri  
Kosovë/a

*Të jetojmë nga toka dhe puna jonë!*  
*Let us live from our land and work!*

E-mail: [info@iadk.org](mailto:info@iadk.org)  
Tel/Fax: +381 (0) 28 536 726  
Web: [www.iadk.org](http://www.iadk.org)

## **PËRMBAJTJA**

Hyrje .....	2
Të arriturat në vitin 2015 .....	3
Partneret që kanë mbështetur projektet e IADK-së gjatë vitit 2015 .....	4
Departamenti i Hortikulturës .....	5
Departamenti i Blegtorisë .....	13
Akreditimi dhe validimi i moduleve të trajnimit në sektorin e blegtorisë.....	14
Departamenti i Përpunimit .....	15
Promovimi i punësimit në sektorin privat .....	17
Krijimi i kushteve të favorshme dhe përmirësimi ekonomik në Jug dhe Veri .....	17
Ofrimi i shërbimeve këshillimore në bashkëpunim me komunat .....	19
Përkrahja me shërbime profesionale për organizatën “LAB” .....	20
Bashkëpunimi me ministrinë e bujqësisë pylltarisë dhe zhvillimit rural .....	20
Bashkëpunimi me partnerë profesional internacional .....	21
Përgatitja e projekt-propozimeve dhe biznes planeve .....	22
Publikimet .....	22
Vizitat e stafit dhe vizitat me fermerë .....	24
Lista e stafit të IADK-së për vitin 2015.....	25
Të hyrat e IADK-së nga partneret dhe Donatorët për vitin 2015 .....	26
Investimet e IADK-së në sektorët e bujqësisë për vitin 2015 .....	27

## **Fjala e drejtorit të IADK-së**

Viti 2015 shënon 11 vjet punë të IADK-së, përkushtim, pasion, dëshirë dhe ambicie për të arritur sa më shumë, për të qenë më pranë fermerëve dhe institucioneve duke i mbështetur ato në zhvillimin e bujqësisë.

Edhe ky vit u karakterizua si një vit jo i lehtë për sektorin e bujqësisë në Kosovë, megjithatë, gjatë këtij viti, sektori i bujqësisë ka rritur më tej peshën e tij në aktivitetin ekonomik të zhvillimit të vendit.

Edhe pse janë dyfishuar fondet në përkrahjen e fermerëve nga qeveria e Kosovës, ZBEK donatorët dhe partnerët tjerë, tani sfida më e madhe e fermerëve mbetet zbatimi i ligjeve në bujqësi, kontrolli i inputeve, ngritja e cilësisë së prodhimeve dhe përgatitja e fermerëve për përmbushjen e obligimeve ndaj MSA-së.

Arritjet e organizatës tonë si liderë në zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural në Kosovë, në zbatimin e projekteve, kryerjen e shërbimeve ndaj palëve, krijimin e partneritetit të qëndrueshëm me partneret tanë gjatë vitit 2015 tregojnë një zhvillim të qëndrueshëm dhe një bazë të shëndetshme për zhvillime të mëtejshme në vitet në vazhdim.

Me qëllim të informimit, ngritjes së transparencës, komunikimit dhe llogaridhënies, IADK edhe këtë vit publikon raportin vjetor për të informuar donatorët, partnerët, fermerët dhe të gjithë të interesuarit për përparimin që kemi bërë drejt arritjes së qëllimeve tona strategjike në kontributin dhënë zhvillimit të bujqësisë në Kosovë.

Donatorët, partnerët, fermerët mund të vërejnë se disa aktivitete të që janë zhvilluar këtë vit, do të jenë edhe në vazhdim gjatë kohës së këtij raportimi sepse IADK në vazhdimësi zbaton projektet në zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Në raport mund gjithashtu të gjenden informata të rëndësishme rreth aktivitetit të buxhetit, mbështetësve financiar, të punësuarve, praktikantëve të cilët kontribuan në arritjen e qëllimeve tona të përbashkëta strategjike në zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Si Drejtor Ekzekutiv, do të doja të falënderoja sinqerisht të gjithë ata që ndër vite kanë bërë të mundur suksesin e organizatës së IADK-së, Bordit të Drejtorëve, punonjësit tanë, fermerët dhe partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë për bashkëpunimin dhe mbështetjen e pakursyer të tyre në rrugëtimin e përbashkët.

Sinqerisht,

Zenel Bunjaku

## **TË ARRITURAT NË VITIN 2015**

### **ME SHUME FAMILJE TË PËRKRAHURA NË MËNYRË DIREKTE**

**183 ekonomi familjare** janë përkrahur direkt nga programet e IADK. Aktivitetet në të cilat janë përkrahur familjet janë: *(serra për kultivim të perimeve, serra për tharje të bimëve mjekësore, inkubator për mbirjen e fidanëve, fidanë dhe inpute për dredhëz, mjedër dhe bimëve mjekësore, kultivimi i specit në fushë të hapur, pako higjienike për përmirësimin e kualitetit të qumështit, makina mjelëse për lopë, koshere për bletë për prodhimtarin organike dhe pajisje të kuzhinës për përgatitjen e ushqimit).*

### **NGRITJA E KAPACITËTËVE NJERZORE NË SEKTORIN E BUJQËSISË**

Gjatë vitit 2015, IADK rendësi të veçantë i ka kushtuar edukimit dhe rritjes së kapaciteteve njerzore në sektorin e bujqësisë. **3702 fermerë, studentë, inxhinier të bujqësisë dhe punëtorë institucional janë trajnuar në 272 sesione të trajnimeve.** Trajnimet kanë përfshirë të gjithë sektorët e bujqësisë.

### **SHKEMBIMI I PËRVOJAVE**

Me qëllim të shkëmbimit të përvojave me vendet dhe organizatat e ndryshme, gjatë këtij viti, IADK ka organizuar **12 vizita** në vend, regjion dhe në vendet e BE ku kanë marr pjesë **163 pjesëmarrës.**

### **MBULIMI I TË GJITHË SEKTOREVE TË BUJQËSISË**

IADK mbulon të gjithë sektorët e bujqësisë me staf profesional për secilin sektor.

### **MË SHUMË VENDE PUNË TË KRIJUARA**

Bizneset, fermeret e përkrahur nga IADK kanë krijuar mundësi për vetëpunësim dhe punësim për anëtarë të familjes apo individë të komunitetit ku jetojnë klientët tanë. Gjatë këtij viti IADK ka ngritur 0.56 ha sipërfaqe me serra, 2.2 ha në kultivimin e bimëve mjekësore, 3.9 ha sipërfaqe në kultivimin e mjedrës dhe 2.9 ha sipërfaqe në kultivimin dredhëzës.

### **ZGJERIM I MËTËJSHËM NË TË GJITHË VENDIN**

Numri i fermerëve të përkrahur për çdo vit është në rritje, çka përbën një bazë të mirë dhe garanci për arritje afatgjate.

### **PROCEDURA DHE PROCESE TË SHPEJTA DHE TRANSPARENTE**

Përzgjedhja e përfituesve, dhe transparenca e gjithë procesit kanë rëndësi për ne. IADK aplikon procesin e përzgjedhjes së përfituesve me anë të poentimit, çka bën të mundur marrjen e vendimit dhe procesin e përzgjedhjes brenda një kohe të shkurtër, transparent dhe pa vonesa.

## **PARTNERET QË KANË MBËSHTETUR PROJEKTET E IADK-SË GJATË VITIT 2015**

Gjatë këtij viti IADK ka vazhduar bashkëpunimin me donatorët me të cilët është krijuar një partneritet afatgjatë në zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural në Kosovë. Po ashtu në vitin 2015 IADK ka arritur të krijojë besimin edhe të donatorëve të rinjë në implementimin e projekteve të përbashkëta me qëllim të arritjes së objektivave tona në zhvillimin bujqësisë në Kosovë.

Gjatë këtij viti, IADK ka filluar të zbatojë projektin 2.5 vjeçar BfW (2015-2017), të financuar nga donatori **Brot für die Welt** (Gjermani) lidhur me “Gjenerimin e të ardhurave dhe aktivitet trajnuese për grupet e marginalizuara dhe fermerët në zonat rurale”

Partnerë tjerë të rëndësishëm që ka përkrahur vazhdimisht IADK është; **Bashkimi Evropian** që është duke financuar projektin dy vjeçar 2015-2016 në Fuqizimin ekonomik dhe ngritjen e kapaciteteve të grave të veja në regjionin e Mitrovicës dhe Prishtinës”.

IADK në bashkëpunim me Programin e USAID-it Avancojmë Kosovën së Bashku (AKT), ka zbatuar projektin “Krijimi i kushteve të favorshme dhe përmirësimi ekonomik në Jug dhe Veri të Kosovës”.

UNDP është një partner tjetër që ka financuar projektin: “Ngritja e kapaciteteve të fermerëve në hortikulturë në komunat e rajonit veri dhe jug të Kosovës”

Bashkëpunim i mirë që ka treguar rezultate të mira në zbatimin e projekteve të përbashkëta dhe ofrimin e shërbimeve këshillimore ka vazhduar me komunat e Vushtrisë, Mitrovicës dhe Drenasit, ku gjatë këtij viti komunat e lartcekura kanë bashkë financuar projekte për përkrahje direkte të fermerëve, ofrimin e shërbimeve këshillimore për fermerët e komunave përkatëse.

IADK në bashkëpunim me projektin e Swiss Contact “Promovimit i Punësimit në Sektorin Privat” PPSE ka bërë vlerësimin e sektorit të përpunimit në shkallë të vogël përpunimin e pemëve dhe perimeve dhe ofrimin e shërbimeve për këta përpunues.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) ka financuar projektin: “Promovimi i kultivimit të mjedrës, dredhëzës dhe përmirësimi i kualitetit të qumështit”

IADK edhe gjatë vitit 2015 ka vazhduar bashkëpunimin me organizatën lokale “Laboratori për Aktivitete të Biznesit” (LAB), nga Hani i Elezit në kryerjen e

shërbimeve profesionale për fermerë, në sektorin e bujqësisë dhe shërbime administrative, financiare dhe menaxheriale për stafin e LAB-it.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të stafit të IADK-së dhe promovimit të praktikave të reja në sektorin e bujqësisë, gjatë vitit 2015 ka vazhduar bashkëpunimi me organizatat me **Ekspertët Senior nga Holanda (PUM)** dhe me **Shoqatën e Fermerëve nga Normandia e Ulët e Francës (AFDI)**, ku me këto dy organizata është bërë shkëmbimi i përvojave në sektorët e bujqësisë.

## DEPARTAMENTI I HORTIKULTURËS

### *NGRITJA E KAPACITËTËVE TË FERMERËVE NË HORTIKULTURË*

Përmes këtij projekti janë përkrahur fermerët në regjionin jugor ( Prizren, Dragash, Suharekë, Mamushë, Rahovec, Malishevë), dhe regjionin verior (Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Zveqan, Leposaviq). Projekti u mundësua nga UNDP, ndërsa është financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Finlandës, dhe ka të bëjë me përkrahjen e fermerëve në sektorin e hortikulturës, ndërsa është zbatuar në bashkëpunim me komunat e lartë cekura.

Në fokus të projektit ka qenë ngritja e kapaciteteve prodhuese dhe njohurive të fermerëve nga sektori i hortikulturës dhe sektorit të bimëve aromatike mjekësore. Në sajë të realizimit të projektit janë përkrahur në mënyrë direkte 71 ekonomi familjare të cilat kanë rrit të hyrat si rezultat i kësaj mbështetje të projektit. Këta dhe shumë fermerë të tjerë (719) janë përkrahur edhe me trajnime dhe ofrimin e shërbimeve këshillimore dhe 105 kanë marrë pjesë në vizita studimore.

Në sektorin e perimeve janë përkrahur 28 fermer me nga një serrë për kultivimin e perimeve me sipërfaqe prej 200 m<sup>2</sup>, e shoqëruar edhe me fidanë të perimeve dhe inpute tjera përcjellëse. Dy fermerë janë mbështetur me nga një dhomë mbirëse të farave të perimeve, kapaciteti i të cilëve është 12 m<sup>3</sup>.

Në sektorin e bimëve aromatike mjekësore janë përkrahur 6 fermer për kultivimin e rignonit të bardhë me sipërfaqe nga 2000 m<sup>2</sup>. Ata janë furnizuar me fidanë të rignonit, me sistem të ujitjes pikë-pikë, si dhe me nga një serrë tharëse me sipërfaqe prej 50 m<sup>2</sup>.

Në sektorin e pemëve të imta fermerët janë ndihmuar për ngritjen e plantacioneve me dredhëz dhe mjedër, të cilat kanë një trend të zgjerimit të sipërfaqeve kultivuese. Në këto komponentë janë përkrah 10 fermerë në kultivimin e dredhëzës me sipërfaqe prej 2000 m<sup>2</sup> dhe 9 fermerë me sipërfaqe prej 1000 m<sup>2</sup>, derisa të mjedra janë përkrahur 10 fermerë për kultivimin e mjedrave me sipërfaqe prej 2000 m<sup>2</sup> dhe 6 fermer me sipërfaqe prej 1000 m<sup>2</sup>. Të gjithë fermerët janë përkrahur me fidanë të dredhëzës, përkatësisht mjedrës dhe me inpute tjera të nevojshme për ngritje të plantacioneve me pemë të imëta.



Përveç përkrahjes direkte për ngritjen e kapaciteteve prodhuese të fermerëve në sektorët e mbështetur, fermerët janë përkrahë edhe në aftësim profesional në fushat e caktuara përmes trajnimeve profesionale dhe këshillave praktike. Këta prodhues janë vizituar dhe monitoruar gjatë gjithë ecurisë së projektit, nga ekspertët e IADK-së.

Në kudër të projektit janë mbajtur edhe dy tryeza të rrumbullakëta me akterët e fushave përkatëse, në të cilat janë diskutuar çështje të rëndësishme për sektorët e caktuar dhe janë nxjerrë rekomandime të cilat janë adresuar te palët në interes dhe me ndikim për të zhvilluar më tej sektorët.

Njëra tryezë është mbajtur për mjedrën, me temën: **“Kushtet dhe kufizimet e zhvillimit të sektorit të mjedrës në Kosovë”** dhe tryeza tjetër është mbajtur për produktet pyjore jo-drusore, me temën: **“Kushtet e zhvillimit të sektorit të produkteve pyjore jo-drusore (PPJD) sipas strategjisë së produkteve jo - drusore në Kosovë”**.

### ***PËRKRAHJA E FERMERËVE NË KULTIVIMIN E PERIMEVE NË SERRA***

Në këtë aktivitet janë përkrahur 28 fermerë me nga një serrë me sipërfaqe prej 200 m<sup>2</sup> dhe inpute përcjellëse me qëllim të kultivimit të llojeve të ndryshme të perimeve dhe krijimin e të hyrave për ekonomitë e tyre familjare. Përveç përkrahjes direkte me serrë dhe inpute tjera përcjellëse, përfituesit janë mbështetur edhe me trajnime dhe këshilla praktike profesionale për kultivim të perimeve dhe shfrytëzim adekuat të serrave, me synim për të arritur rezultate sa më të larta në prodhimtarinë e perimeve.

Për të pasur një orientim më të lehtë për të ardhmen fermerët janë pajisur me libër për mbajtjen e shënimeve nga aktivitetet që janë zhvilluar në serrë, ku janë evidentuar data e mbjelljes, llojet dhe kultivarët e mbjellë, sasi të plehrave dhe pesticideve të përdorura, koha e vjeljes, sasi të prodhimeve të shitura etj.



Nga 28 serra, sipërfaqja e përgjithshme e të cilave është 0.56 ha, deri në fund të shtatorit kur edhe vegetacioni thuajse ka qenë në përfundim janë vjelë 88,490 kg perime të ndryshme (tranguj, spec dhe domate), që mesatarisht për secilën serrë i bie të jenë vjelë nga 3,160 kg perime të freskëta, e që është një prodhim shumë i mirë duke pasur parasysh se shumica e fermerëve kanë mbjellë lloje të ndryshme të perimeve brenda serrës, dhe jo vetëm një lloji të perimeve. Disa nga fermerët që kanë pasur të kultivuar tranguj, pas marrjes së prodhimit kryesor të trangujve, kanë mbjellë për herën e dytë trangujt kornishon dhe kështu kanë rritë të hyrat për

sipërfaqe të serrës. Problem shqetësues për fermerët këtë vit ka qenë çmimi jo stabil dhe i ultë i domateve, cili nuk ka pasur këso rënie në 4 apo 5 vitet e fundit, megjithatë të hyrat e përgjithshme nga shitjet e perimeve prej 28 serrave janë afërsisht 27,000.00 €, e të cilat do të mund të rriten ende nga kultivimi i perimeve vjeshtore, si janë spinaqi, sallata apo qepët.

### ***INKUBATORËT PËR MBIRJE TË FARËRAVE TË PERIMEVE***

Në këtë aktivitet janë përkrahur dy fermerë me nga një inkubatorë (dhomë para mbirëse) me kapacitet prej 12 m<sup>3</sup> të cilët janë shfrytëzuar për vendosjen e moduleve me fara të mbjella të perimeve, me qëllim të mbirjes më të shpejtë dhe uniforme të farave, shkurtimin e periudhës së prodhimit të fidanëve, si dhe uljen e shpenzimeve të prodhimit të fidanëve. Të dy prodhuesit kanë prodhuar afërsisht 80 mijë fidanë cilësorë të perimeve dhe se shpenzimet për prodhimin e fidanëve si rezultat i shfrytëzimit të inkubatorëve janë zvogëluar për 30%. Nga shitja e këtyre fidanëve janë krijuar të hyra prej 13,200 €, ndërsa në vitet e ardhshme fermerët si rezultat i përmirësimit të kualitetit të fidanëve do të ngritin kapacitetet prodhuese për 35%.



### ***KULTIVIMI I RIGONIT TË BARDHË***

Me qëllim të krijimit të përfitimeve nga kultivimi i bimëve aromatike mjekësore, në kuadër të projektit janë përkrahur gjashtë fermerë për të ngritur fusha me bimë aromatike mjekësore, përkatësisht secili nga fermerët janë përkrahur me fidanë të rigonit të bardhë për mbjellje të ngastrave me sipërfaqe prej 2000 m<sup>2</sup>, si dhe me sistem të ujitjes pikë-pikë, si dhe serra tharëse me sipërfaqe prej 50 m<sup>2</sup>.

Përfituesit kanë marrë edhe mbështetje profesionale për teknikat e kultivimit, vjeljes, tharjes, paketimit dhe ruajtjes së bimëve të kultivuara. Ndonëse viti i parë i kultivimit më tepër është vit i ngritjes së plantacionit, ndërsa prodhimi maksimizohet nga viti i dytë e tutje, e që mund të shfrytëzohet për së paku në 5 vitet vijuese, megjithatë





fermerët në kosën e parë kanë përfituar mesatarisht nga 185 kg masë të tharë të rigonit, të cilën e kanë dorëzuar në kompaninë grumbulluese në Istog, me një çmim prej 1.50 €/kg, ndërsa në vitet e ardhshme për shkak të rritjes së densitetit të bimëve dhe fillimit të vegjetacionit të bimëve në pranverën e hershme, si dhe mundësisë së dy kositjeve brenda vitit do të merren së paku nga 1,500 kg masë e tharë e bimëve.

### ***KULTIVIMI I DREDHËZAVE***

Kultivimi i dredhëzave nga viti në vit është duke u zgjeruar në ngastrat e fermerëve dhe për këtë janë përkrahur 19 fermerë, prej të cilëve 9 fermerë kanë ngrit plantacione me dredhëza me sipërfaqe prej 1000 m<sup>2</sup> dhe 10 fermerë plantacione me sipërfaqe prej 2000 m<sup>2</sup>. Në kultivimin e suksesshëm të dredhëzave ka ndikuar edhe mbështetja me trajnime dhe këshilla praktike dhe vizitave studimore.

Të gjitha ngastrat me dredhëza janë zhvilluar shumë mirë dhe fermerët kanë mësuar teknikën e kultivimit që nga mbjellja e deri në vjelje, dhe masat e për kujdesit ndaj bimëve pas vjeljes. Po ashtu ata janë udhëzuar që të mbajnë shënime në librin e shënimeve të dhënë, me qëllim të evidentimit të dhënave, siç janë; data e mbjelljes, llojet dhe kultivarët e mbjellë, sasinë e plehrave dhe pesticideve të përdorura, koha e vjeljes, sasinë e prodhimeve të shitura etj. Këto të dhëna do të ju ndihmojnë fermerëve gjatë viteve të ardhshme për të parë aktivitetet dhe veprimet të cilat janë ndërmarrë në periudha të ndryshme gjatë vegjetacionit të bimëve.



Nga të dhënat e evidentuara të fermerëve kemi nxjerrë një pasqyrë të përgjithshme të frutave të vjela, ku kjo sasi është e vogël për shkak se dredhëzat vitin e parë japin një prodhim simbolik ngase është bërë eliminimi i luleve. Mirëpo edhe pse është bërë eliminimi i luleve për të favorizuar zhvillimin e masës vegjetative të bimëve, me qëllim që vitin e ardhshëm të kemi prodhimtari të lartë dhe cilësore të dredhëzave, prapë kanë ngelur disa lule të cilat kanë dhënë fruta të dredhëzave, e që nga 19 pemishte me dredhëza, sipërfaqja e përgjithshme e të cilave është 2.9 ha, janë vjelë përafërsisht 2,900 kg dredhëza që mesatarisht për ngastër prej 1000 m<sup>2</sup>, i bie të jenë vjelë nga 100 kg fruta të dredhëzave, por shikuar nga aspekti i zhvillimit të masës vegjetative të bimëve jemi të sigurt se vitin e ardhshëm nga ngastrat prej 1000 m<sup>2</sup>, do të arrihen së paku 4,000 kg dredhëza me kualitet shumë të mirë.

### ***KULTIVIMI I MJEDRAVE***

Edhe mjedra është një kulturë shumë me perspektivë nga pemët e imëta, e cila ka marrë një trend të hovshëm të zgjerimit të sipërfaqeve kultivuese në disa zona të vendit tonë. Në këtë aktivitet janë përkrahur 16 fermerë për kultivimin e mjedrës, prej të cilëve 6 fermerë kanë mbjellë mjedrën në ngastra me sipërfaqe prej 1000 m<sup>2</sup> dhe 10 fermerë kanë mbjellë mjedrën në sipërfaqe me nga 2000 m<sup>2</sup>. Përveç përkrahjes direkte me fidanë dhe inpute tjera përcjellëse, fermerët janë mbështetur edhe me trajnime për të gjitha teknikat e kultivimit të mjedrës, si dhe janë monitoruar me qëllim të ofrimit të këshillave praktike gjatë vegetacionit.

Ngastrat me mjedra përgjithësisht kanë pas zënje të mirë dhe kanë arritur një zhvillim premtues për të dhënë prodhimtari të lartë në vitin e ardhshëm dhe viteve tjera vijuese. Edhe kultivuesit e mjedrave janë pajisur me libër për mbajtjen e shënimeve të aktivitetet që janë zhvilluar gjatë kultivimit të mjedrave, ku janë evidentuar data e mbjelljes, llojet dhe kultivarët e mbjellë dhe sasi të plehrave dhe pesticideve të përdorura për trajtimin e bimëve. Prodhimi i frutave në vitin e parë është shumë simbolik, dhe frutat e prodhuara janë shfrytëzuar kryesisht për konsum familjar. Gjithsesi, mënyra e përgatitjes dhe zhvillimit të bimëve është shumë premtuese për të arritur në vitet vijuese së paku nga 1,500 kg fruta të mjedrave në sipërfaqe prej 1000 m<sup>2</sup>.



### ***KULTIVIMI I SPECIT NË FUSHË TË HAPUR***

Në kuadër të aktivitetit “mbështetja e fermerëve të vegjël në hortikulturë për gjenerimin e të ardhurave”, janë përkrahur 10 fermerë në kultivimin e specit në fushë të hapur, në ngastra me sipërfaqe nga 1000 m<sup>2</sup>. Prej tyre shtatë fermerë janë nga Komuna e Vushtrrisë dhe tre nga Komuna e Mitrovicës. Për secilin prej tyre janë siguruar farërat e specit të një kultivari të quajtur “Dukat”. Ky kultivar ka kapacitet të lartë prodhues dhe cilësi të mirë të frutave për përpunim në ajvar, pastaj për



konservim dhe përdorime tjera në industrinë përpunuese. Përveç farërave fermerët kanë marrë edhe sistemin e ujitjes pikë-pikë, si dhe shërbimet këshillimore për praktikat e kultivimit të specit, që nga mbjellja e farërave e deri në mbjellje, kultivim dhe vjelje të frutave.

Në përgjithësi kultivimi i këtij kultivari është treguar i suksesshëm sidomos në toka të lehta dhe të plehëruara me pleh organik, që ka dhënë një prodhim prej 4000 kg në 1000 m<sup>2</sup>, ndërsa mesatarja e prodhimit është përafërsisht nga 2000 kg/1000 m<sup>2</sup>. Fermerët kanë plasuar specat në tregun lokal, në dyqane dhe marketet të ndryshme me një çmim mesatar nga 0.40 €/kg, ndërsa disa prej fermerëve një pjesë të prodhimit e kanë përpunuar në ajvar, apo konservuar në mënyrë shtëpiake. Në tokat e rënda dhe jo mirë të kulluara kemi pasur paraqitje të infeksioneve nga vrugu dhe kalbëzimi i frutave, e që duhet pasur kujdes në vitet e ardhshme.

### ***KULTIVIMI I RIGONIT TË BARDHË***

Edhe mbështetja në kultivimin e bimëve mjekësore aromatike ka qenë një komponentë e rëndësishme përmes së cilës këtë vit janë përkrahur tetë fermerë për ngritjen e fushave me rigon të bardhë. Përfituesit e përkrahur janë nga Drenasi (3), Vushtrria (3) dhe Mitrovica (2), ku secili prej tyre kanë përfituar fidanët e rignonit të bardhë për mbjelljen e ngastrave me nga 1000 m<sup>2</sup>, pastaj sistemin e ujitjes pikë-pikë, dhe asistencën profesionale për mbjellje, kultivim, vjelje e tharje të bimëve. Rigoni është një bimë pesë vjeçare e cila nuk kërkon shpenzime gjatë vegetacionit, përveç mirëmbajtjes së tokës nga barojat e këqija, ujitjen gjatë periudhave me thatësi dhe kositjen e tharjen e masës bimore.



Viti i parë më tepër është vit i ngritjes së plantacionit dhe përgatitjes së bimëve për prodhim në vitet pasuese, megjithatë fermerët kanë prodhuar mesatarisht nga 90 kg masë të tharë të rignonit, e cila i është dorëzuar kompanisë grumbulluese me një çmim prej 1.5 €/kg.

Vitet e ardhshme prodhimi për njësi sipërfaqeje do të shumëfishohet për shkak të rritjes së densitetit të bimëve, fillimit të vegetacionit nga pranvera e hershme dhe mundësisë së arritjes së dy kositjeve brenda vitit.

### ***PROMOVIMI I PRODHIMIT ORGANIK TË MJEDRAVE***

Në këtë komponentë janë përkrahur 13 fermerë për kultivim të mjedrës në mënyrë organike. Atyre u janë furnizuar me një pako për ngritje të plantacioneve të mjedrës në sipërfaqe prej 1000 m<sup>2</sup>, dhe kjo pak përmban: 1100 fidanë mjedre të kultivarit “Polka”, sistemin e ujitjes pikë-pikë për sipërfaqen prej 1000 m<sup>2</sup>, një broshurë për kultivim të mjedrës, si dhe ofrimin e trajnimeve dhe këshillave praktike në teren gjatë ngritjes së pemishteve me mjedër. Fermerët e përkrahur janë nga komunat Mitrovicë (2), Drenasi (10) dhe Vushtrria (1).



### ***ORIENTIMI I FERMERËVE NË PRODHIMIN ORGANIK TË PERIMEVE***

Gjatë këtij viti janë formuar pesë grupe të fermerëve për të ndjekur trajnimet në fushën e bujqësisë organike. Secili grup është i përbërë prej 10 fermerëve të cilët merren me kultivimin e perimeve. Këto grupe të fermerëve janë formuar në pesë komuna (Podujevë, Vushtrri, Mitrovicë, Drenas dhe Malishevë), ndërsa me secilin grup janë mbajtur nga dy tema të trajnimeve për parimet e përgjithshme të bujqësisë organike dhe mbrojtjen e perimeve në bujqësinë organik. Në vitin e ardhshëm në secilën prej këtyre pesë grupeve do të përkrahet nga një fermerë me disa inpute biologjike si janë feromonet, grackat, ngjitës të verdhë etj.), me qëllim të demonstrimit të praktikave të prodhimit organik nga grupet e fermerëve.



### ***KOMPOSTIMI DHE SUBSTRATI***

Në këtë aktivitet është përkrahur një fermerë nga Vushtrria për të bërë kompostimin e mbeturinave bimore dhe prodhimin e substratit të vlefshëm për përdorim në hortikulturë. Për të përfituruar njohuri rreth procesit të kompostimit të mbeturinave bimore, IADK ka sjellë një ekspert nga Holanda, cili ka bartur eksperiencat e tij të një grup fermerësh si dhe të stafi përgjegjës i hortikulturës në IADK. Nga këto njohuri bazike për konceptin e prodhimit të substratit nga mbetjet bimore dhe plehu i stallës, është nxitur njëri nga



fermerët pjesëmarrës në trajnimet e organizuara nga IADK, i cili ka investuar në blerjen e disa makinerive të përdorura, të cilat janë të domosdoshme gjatë procesit të kompostimit, ndërsa IADK ka siguruar një pjesë të mjeteve financiare për blerjen e një materiali të quajtur “top tex”, i cili shërben për mbulimin e masës së grumbulluar organike gjatë procesit të kompostimit, si dhe ofrimin e informacioneve të nevojshme për teknologjinë e kompostimit. Fermeri me sukses ka vazhduar punën dhe në fund të vitit ka përfunduar procesi i kompostimit ku ka prodhuar rreth 150 m<sup>3</sup> kompost të kualitetit të lart. Edhe në dy vitet e ardhshme do të zhvillohet i njëjti aktivitet në dy komuna tjera, për të promovuar praktikën e kompostimit të mbetjeve bimore dhe prodhimin e substratit prej tyre.



### ***MONITORIMI I NGASTRAVE TË MBJELLA ME PATATE***

IADK ka mbikëqyr kultivimin e patateve në një sipërfaqe prej 40 ha, e cila është e shpërndarë në disa ngastra të cilat gjenden në Komunën e Vushtrrisë dhe të Obiliqit, dhe janë ndarë në pesë blloqe/zona, në të cilat janë testuar disa produkte humifikantë të një kompanie nga Zvicra e quajtur “BIOMA”. Fermeri i përkrahur nga kompania “BIOMA” për testimin e këtyre produkteve është Nuradin Imeri nga fshati Dumnice e Ulët/ Komuna Vushtrri, i cili është përkrahur edhe me farë të patates dhe të gjitha inputet tjera të nevojshme për kultivimin e patateve në sipërfaqen e lartcekur. Në këtë aktivitet është përcjellë e gjithë puna që është bërë që nga marrja e mostrave për analiza të pjellorisë së tokës, evidentimi i ngastrave, ndarja në zona dhe mënyra e testimit të produkteve, rekomandimet për dozat e plehut mineral, pastaj evidentimi i gjithë praktikave të kultivimit, i përdorimit të produkteve humifikuese, të cilat janë përdorur në trajtimin e tokës dhe trajtimin e bimëve në faza të ndryshme të zhvillimit të bimëve, e deri në nxjerrjen e patateve. Përveç këtyre aktiviteteve janë organizuar edhe dy ditë fushore me fermerë kultivues të patateve dhe zyrtarë të departamenteve komunale për bujqësi, për të promovuar këtë program të kultivimit të patateve dhe ndikimet pozitive të produkteve të përdorura. IADK së bashku





me Kompaninë ‘BIOMA’ e cila është e interesuar të vazhdojë përkrahjen e fermerit edhe në 2016, do të bëjnë përpunimin e të dhënave dhe publikimin e tyre.

## DEPARTAMENTI I BLEGTORISË

### ***PRODHIMTARIA ORGANIKE E MJALTIT***

Me qëllim të rritjes së vlerës së produkteve të bletëve dhe plotësimit të standardeve, IADK edhe gjatë vitit 2015 ka përkrahur sektorin e bletarisë në prodhimtarinë organike të mjaltit. Sipas rregullave të Bashkimit Evropian minimumi një për qind e prodhimtarisë së përgjithshme bujqësore të shteteve anëtare duhet të jetë prodhimtari organike. Sektori i bletarisë në Kosovë ka mundësi shumë të mëdha në konvertim në prodhimtarinë organike falë kushteve natyrore që ka Kosova dhe disa zonave që janë shumë të pastra dhe i plotësojnë standardet për vendosjen e parqeve të bletëve për konvertim në prodhimtarinë organike.

Pasi që prodhimtaria organike e mjaltit është në fazën fillestare në Kosovë dhe njohuritë për këtë sektor mungojnë, IADK ka trajnuar grupin e parë të bletarëve lidhur me procedurat për konvertim në prodhimtarinë organike, standardet dhe kushtet për konvertim. Trajnimet i kanë ndjekur 16 bletarë dhe në fund të trajnimit të gjithë pjesëmarrësit kanë marrë njohuritë e duhura për konvertim në prodhimtarinë organike të mjaltit. Nga grupi i pjesëmarrësve në trajnim, IADK ka përzgjedhë një bletarë ku është përkrahur me koshere të bletëve të cilat i plotësojnë standardet dhe janë të ndërtuara nga materiali i cili lejohet në prodhimtarinë organike. Gjatë vitit 2016 me fermerin e përzgjedhur do të fillohet me procedurat e konvertimit në prodhimtarinë organike, ku bletët do të vendosen në një vend larg vendbanimeve dhe ku nuk përdoren plehra dhe pesticideve në një diametër prej 3 km.



Sektori i bletarisë do të përkrahet nga IADK edhe në vitet në vazhdim ku do të vazhdojmë në ngritjen e kapaciteteve të bletareve në prodhimtarinë organike.

## ***MENAXHIMI I PLEHUT NË FERMË DHE RUAJTJA E AMBIENTIT***

Sektori i bujqësisë në veçanti blegtoria kontribuon me rreth 18 % në ngrohjen globale apo i ashtuquajturit efekti serre (FAO 2006). Burimet kryesore dhe llojet e gazrave janë metani, dyoksidi i karbonit dhe oksidi i azotit nga plehu i stallës. Emetimet e gazrave serre në sektorin e blegtorisë mund të reduktohen përmes teknologjive dhe menaxhimit të mirë të plehut të stallës. Për këtë qëllim, IADK gjatë vitit 2015 ka përgatitur kurrikulat e trajnimit për menaxhimin e plehrave dhe ka formuar dy grupe të fermerëve (30 fermerë) në komunën e Vushtrisë dhe Drenasit. Secili grupe ka ndjekur nga 5 tema të trajnimit. Po ashtu është përgatitur një fletëpalosje lidhur me ndërtimin e depove të plehut dhe menaxhimin e plehut.



## ***AKREDITIMI DHE VALIDIMI I MODULEVE TË TRAJNIMIT NË SEKTORIN BLEGTORISË***

Me qëllim të edukimit dhe ngritjes së kapaciteteve njerëzore në sektorin e bujqësisë, IADK gjatë vitit 2015 ka aplikuar në Autoritetin Kombëtarë të Kualifikimeve për akreditimin dhe validimin e moduleve të trajnimit në profilin e blegtorisë sipas standardit kombëtar të kualifikimeve.

Qëllimi i akreditimit dhe validimit të moduleve në profilin e blegtorisë është harmonizimi i planeve në bazë të plan programeve të vendeve të BE dhe ato të rajonit, bazuar në paraqitjen e interesave të sektorit të blegtorisë në Kosovë. Ky program do të mundësoj fermerëve, studentëve dhe të gjithë pjesëmarrësit që do të ndjekin modulet standardet me të larta në sektorin e blegtorisë dhe menaxhimit të fermës, e fokusuar në rritjen e profitabilitetit të fermës, prodhimin të sigurt të ushqimit dhe ndikimi i tyre në vendimmarrjen menaxheriale të fermës. Modulet të cilat zhvillohen në këtë program, kanë për qëllim të formojnë ekspertë të aftë në aspektin praktik me dije dhe shkathtësi për të zbatuar teknologjitë me të reja të zhvillimit për nevojat e menaxhimit të fermës.

IADK ka kryer të gjitha proceset dhe përgatitjen e moduleve dhe është në pritje të konfirmimit nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve për akreditim.

## DEPARTAMENTI I PËRPUNIMIT TË USHQIMIT

### ***TRAJNIMET NË MODULIN E QUMËSHITIT***

Në këtë modul është trajnuar një grup i grave me gjithsej 13 gra nga fshati Oshlan, komuna e Vushtrrisë.

Ky modul ka përmbajtur 20 sesione të trajnimeve ku gratë janë trajnuar në prodhimin e 5 llojeve të ndryshme të djathit. Nga ky numër 7 gra kanë filluar edhe shitjen e djathit në treg në vlerë prej 3851 euro.



### ***FUQIZIMI EKONOMIK I GRAVE NË VISET RURALE***

Duke i parë vështirësitë e grave në viset rurale dhe grave kryefamiljare, IADK gjatë këtij viti i ka dhënë prioritet këtij grupi me qëllim të krijimit të kushteve me të mira dhe krijimit të vendeve të reja të punës.

Për të arritur këtë qëllim, IADK gjatë këtij viti ka trajnuar grupet e grave në përgatitjen e ushqimit për nxënësit e shkollave. Në kuadër të këtij aktiviteti janë trajnuar 86 gra në përgatitjen e ushqimeve të ndryshme për nxënësit e shkollave në 10 sesione të trajnimeve. Pas përfundimit të trajnimit, gratë kanë marrë njohuri të mjaftueshme në përgatitjen e 8 llojeve të ndryshme të ushqimeve. Po ashtu grupet e grave kanë ndjekur trajnime në aspektin ekonomik në mënyrë të menaxhimit sa me të mirë të bufeve.

### ***KRIJIMI SHTATË BUFEVE NË SHKOLLA***

Mbas përfundimit të trajnimeve për përgatitjen e ushqimit dhe trajnimeve ekonomike së bashku me zyrat komunale të punësimit janë përzgjedhur 28 gra të cilat janë punësuar në 7 bufet e krijuara. Së bashku me drejtorit e Arsimit të komunave Mitrovice, Vushtri, Drenas dhe Skenderaj, janë përzgjedhur 7 shkollat ku janë krijuar bufet në këto shkolla:

1. SHFMU "Musa Hoti" Mitrovice



2. SHMU-2 Vushtrri
3. SHFMU"Shaban Jashari" Skenderaj
4. SHFMU"Ahmet Delia" Skenderaj
5. SHFMU" Ali Gashi" Drenas
6. SHFMU"Enver Hadri" Smrekonice, komuna e Vushtrrisë dhe
7. SHFMU"Halil Bajraktari" Drenas



Mbas përzgjedhjes IADK ka ndihmuar në renovimin e hapësirave të përcaktuara për bufe dhe janë pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme për funksionalizimin e bufeve.

Me fillimin e vitit shkollor është bërë edhe funksionalizimi i bufeve ku janë punësuar 28 gra në përgatitjen e ushqimit për nxënësit e këtyre shkollave, përafërsisht 4000 nxënës dhe staf i shkollës ushqehen në këto bufe. Këto 28 gra arrijnë të krijojnë të ardhura në vlerë mesatare prej 250 – 500 € varësisht nga numri i nxënësve në shkollat e përzgjedhura.

### ***PROMOVIMI I PRODUKTEVE***

IADK ka ndihmuar përfitueset e projekteve, përpunueset në pjesëmarrje në panaire të ndryshme siç janë:

1. Panairi i produkteve bujqësore-MBPZHR dhe OEK
2. Panairi regjional “ Mitrovica 2015
3. Panairi “Blej Shqip” organizuar nga komuna e Prishtinës

Në këto panaire kanë marrë pjesë 18 gra të cilat kanë bërë shitje të produkteve në vlerë prej 4354 euro.



## PROMOVIMI I PUNËSIMIT NË SEKTORIN PRIVAT

Edhe gjatë vitit 2015 është vazhduar bashkëpunimi në mes të IADK gjegjësisht departamentit të përpunimit me projektin e Swiss Contactit, **projektit PPSE-promovimi i punësimit në sektorin privat**

Bashkëpunimi është zhvilluar në ofrimin e shërbimeve në dy aktivitetet:

- Vlerësimi i subjekteve të përfshira në përpunimin e frutave dhe perimeve me kapacitet të vogla të përpunimit. Në kuadër të këtij aktiviteti është krijuar baza me 25 subjekte të identifikuara me të gjitha të dhënat për të gjithë përpunuesit, kërkesat dhe sfidat me të cilat përballet ky sektorë.
- Ofrimi i shërbimeve tek gratë e përfshira në projekt të PPSE në konservimin e perimeve. Në kuadër të këtij aktiviteti ekspertët e IADK kanë trajnuar 5 gra të përfshira në projekt në përpunimin e /konservimin e perimeve të ndryshme. Të gjitha gratë e trajnuar produktet i kanë shitur në kompaninë 'Rizona e cila e ka bërë eksportin e këtyre produkteve në vendet e BE



## KRIJIMI I KUSHTEVE TË FAVORSHME DHE PËRMIRËSIMI EKONOMIK NË JUG DHE VERI TË KOSOVËS

IADK në bashkëpunim me Programin e USAID-it Avancojmë Kosovën së Bashku (AKT), ka implementuar projektin “Krijimi i kushteve të favorshme dhe përmirësimi ekonomik në Jug dhe Veri të Kosovës”.

Projekti ka pasur efekt në rritjen e ekonomike të fermerëve duke rritur të ardhurat nga rritja e prodhimtarisë së qumështit, përmirësimi i cilësisë, rritjen e vlerës së produkteve bujqësore dhe kultivimin e bimëve mjekësore. Po ashtu projekti ka kontribuar në aspektin social dhe bashkëpunimin në mes komuniteteve nëpërmes shkëmbimit të përvojave në



mes komunave në Veri dhe Jug të Kosovës. Projekti ka përkrahur fermerët nga komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan, Shtërpcë dhe Novobërdë.

**Në sektorin e blegtorisë,** 4 grupe të fermerëve janë trajnuar në 10 module të trajnimit në aspektin e menaxhimit të fermave, rritjen e prodhimit të qumështit dhe përmirësimin e kualitetit të qumështit. Në total janë trajnuar 203 pjesëmarrës në katër komunat e lartcekura.

Me qëllim të përmirësimit të kualitetit të qumështit dhe aplikimit të praktikave të mira në fermë, 20 fermerë të cilët kanë ndjekur trajnimet nga komunat e Shtërpcës dhe Novobërdës janë përkrahur me pako higjienike.



**Në sektorin e përpunimit shtëpiak,** 2

grupe të grave janë trajnuar në përpunimin e pemëve dhe perimeve. Secili grup ka pasur nga 10 gra pjesëmarrëse në trajnim. Grupi i grave nga komuna e Shtërpcës janë trajnuar në përpunimin e pemëve në 10 module të trajnimit ku gratë janë aftësuar në përgatitjen e 4 recepturave të ndryshme në përpunimin e xhemit. Ndërsa grupi i grave nga komuna e Leposaviqit janë trajnuar në përpunimin e perimeve në 10 module të trajnimit dhe janë aftësuar në përgatitjen e 4 recepturave për përpunimin e perimeve. Grupet e grave kanë qenë nga komuniteti shqiptar dhe serb.



**Në sektorin e bimëve mjekësore** janë trajnuar 2 grupe të fermerëve në komunat e Leposaviqit dhe Zubin Potokut. Trajnimet i kanë ndjekur 35 pjesëmarrës në katër module të trajnimit lidhur me kultivimin e bimëve mjekësore. Me qëllim të promovimit dhe krijimit të bizneseve të reja, janë përkrahur me inpute dhe materiale shtesë dy fermerë në Leposaviq dhe Zubin Potok në kultivimin e bimëve mjekësore të mëllagës së zezë dhe rignonit. Të dy fermerët kanë filluar me këtë biznes të ri dhe janë përkrahur në gjetjen e tregut ku falë projektit fermerët e kanë tregun e sigurt për shitjen e bimëve mjekësore.

Vlen të theksohet se me ndihmën e projektit janë organizuar vizita të ndryshme me qëllim të shkëmbimit të përvojave në mes komuniteteve dhe fermerëve. Është realizuar një tryezë e rumbullakët lidhur me sektorin e qumështit ku kanë marrë pjesë të gjithë

hisedarët në këtë sektor si MBPZHR, MTI, AVUK, Shoqatat e prodhuesve dhe përpunuesve të qumështit, fermerët, qumështoret. Rekomandimet e dala nga tryeza ju janë dorëzuar të gjithë akter[ve dhe disa prej tyre janë marrë në konsiderim nga institucionet përkatëse.

Si përfundim në kuadër të këtij projekti janë trajnuar **465 pjesëmarrës** (përfaqësues të komunave, përfaqësues të bizneseve, fermer të cilët kanë marr pjesë në 38 ditë trajnime të ndryshme.

## **OFRIMI I SHËRBIMEVE KËSHILLIMORE NË BASHKËPUNIM ME KOMUNAT**

“IADK në bashkëpunim me komunat e Vushtrrisë, Mitrovicës dhe Drenasit ka vazhduar bashkëpunimin në bashkëfinancimin e projekteve (granteve) dhe kryerjen e shërbimeve këshillimore për fermerët nga “IADK” në komunat përkatëse.

Në komunën e Vushtrrisë në kuadër të këtij bashkëpunimi janë bashkëfinancuar aktivitete të ndryshme si në kultivimi i rigonit të bardhë, kultivimi i mjedrave organike, përgatitja e kompostit dhe substratit, kultivimi i specit në fushë të hapur, investimet në kuzhinat e shkollave, prodhimtaria organike e mjaltit ku janë përkrahur **21 përfitues**. Ndërsa në kuadër të shërbimeve këshillimore në komunën e Vushtrrisë janë trajnuar në mënyrë direkte **101 fermerë** në sektorin e bletarisë dhe sektorin e perimeve.

Në komunën e Drenasit në kuadër të bashkëfinancimit të projekteve janë përkrahur **21 përfitues** në kultivimin e rigonit të bardhë, kultivimi i mjedrave organike dhe investimet në kuzhinat e shkollave. Në kuadër të shërbimeve këshillimore janë përkrahur **260 fermerë**.



Në komunën e Mitrovicës janë bashkëfinancuar aktivitete në Kultivimin e rigonit të bardhë, Kultivimi i specit në fushë të hapur, Kultivimi i mjedrave organike dhe Investimet në kuzhinën e shkollës ku janë përkrahur **11 përfitues**.

*Përkrahja e fermerëve në kuadër të bashkëfinancimit dhe ofrimit të shërbimeve këshillimore në bashkëpunim me komunat Vushtrri, Mitrovicë dhe Drenas*

<b>Nr.</b>	<b>Komuna</b>	<b>Fermerët që janë përkrahur me investime direkte në fermë</b>	<b>Fermerët që janë përkrahur me shërbime këshillimore</b>
1	Vushtrri	21	101
2	Mitrovicë	11	-
3	Drenas	21	260
<b>Totali</b>		<b>53</b>	<b>361</b>

### **PËRKRAHJA ME SHËRBIME PROFESIONALE PËR ORGANIZATËN “LABORATORI I AKTIVITETEVE TË BIZNESIT (LAB)”**

IADK edhe gjatë vitit 2015 ka vazhduar bashkëpunimin me organizatën lokale “Laboratori për Aktivitete të Biznesit” (LAB), nga Hani i Elezit në kryerjen e shërbimeve profesionale për fermerë, në sektorin e bujqësisë dhe shërbime administrative, financiare dhe menaxheriale për stafin e LAB-it. Gjatë këtij viti janë trajnuar fermerët në sektorin e hortikulturës në kultivimin e perimeve, frutave të imëta dhe në bletari.

### **BASHKËPUNIMI ME MINISTRINË E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Gjatë këtij viti IADK ka implementuar projektin “Promovimi i kultivimit të mjedrës, dredhëzës dhe përmirësimi i kualitetit të qumështit”. Aktivitet e projektit kanë përfshirë komunat; Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Drenas, Zubin Potok, dhe Leposaviq. Në secilën komunë janë formuar grupet e fermerëve dhe secili grup ka ndjekur nga tri tema të trajnimit në sektorin përkatës.

Në kultivimin e mjedrave janë trajnuar 169 fermerë në 5 grupe. Në kultivimin e dredhëzës janë trajnuar 168 fermerë në 5 grupe të ndryshme. Secili grup i fermerëve kanë ndjekur nga tri tema të trajnimit.

Në përmirësimin e kualitetit të qumështit janë trajnuar 119 fermerë në 4 grupe të ndryshme, secili grup ka ndjekur nga tri tema të trajnimit. Trajnimet janë organizuar në mënyrë teorike dhe praktike ku së bashku me fermerët janë realizuar trajnime praktike në fermë.

## BASHKËPUNIMI ME PARTNERË PROFESIONAL INTERNACIONAL

Edhe gjatë vitit 2015 ka vazhduar bashkëpunimi me partneret nga vendet e Bashkimit Evropian.

Me organizatën PUM nga Holanda (Ekspertë Senior) janë realizuar 6 misione në sektorë të ndryshme në bujqësi dhe zhvillim rural.

**Në sektorin e blegtorisë** gjatë vitit 2015 është angazhuar një ekspert për menaxhimin e plehut të stallës dhe menaxhimin e kullosave nga organizata PUM. Gjatë këtij misioni fermerët janë trajnuar dhe janë këshilluar se si duhet të bëhet menaxhimi i plehut të stallës, ndërtimin e depos për pleh të ngurtë dhe të lëngët dhe metodat për shpërndarjen e plehut të stallës. Po ashtu fermerët janë trajnuar se si duhet të bëhet menaxhimi i kullosave, shfrytëzimi i tyre për kullosje. Gjatë misionit është arrit të përgatiten modulet e trajnimeve për temat e lartcekura.

**Në sektorin hortikulturës** është angazhuar një ekspert nga organizata PUM për përgatitjen e kompostimit nga mbetjet organike dhe plehu i stallës. Gjatë këtij misioni fermerët dhe stafi i IADK janë trajnuar për procesin e kompostimit dhe prodhimin e substratit, ku falë kësaj eksperience një fermer ka investuar dhe prodhuar substratin nga mbetjet organike dhe plehu i stallës.

**Në sektorin e Përpunimit të ushqimit** është angazhuar Eksperti i PUM i cili së bashku me stafin e IADK-së kanë hartuar draft programin e veçantë të trajnimit profesional (modulet teorike dhe praktike) për përgatitjen e ushqimit nga brumërat dhe këshilla të ndryshme tek bufet e krijuara që nga higjiena, përdorimi i pajisjeve deri tek puna praktike në përgatitjen dhe pjekjen e 5 produkteve ushqimore.



**Dy misione tjera të ekspertëve të PUM-it**, janë realizuar në kuadër të gjithë sektorëve të IADK-së, me qëllim të ofrimit të përvojave të tyre në fushat përkatëse, dhe përgatitjen e moduleve të trajnimit në sektorin e blegtorisë.

## **SHKËMBIMI I PËRVOJAVE ME ORGANIZATËN AFDI NGA FRANCA**

Gjatë vitit 2015 IADK ka vazhduar bashkëpunimin me shoqatën AFDI në shkëmbimin e përvojave në sektorin e bujqësisë. Gjatë vitit 2015 përfaqësuesit e AFDI-të kanë realizuar një vizitë në Kosovë. Qëllimi i vizitës ka qenë që t'u ndihmohet fermerëve në menaxhimin sa më të mirë të fermave, menaxhimin e plehut të stallës, balancimin e racioneve ushqimore. Gjatë trajnimeve fermerët janë trajnuar lidhur me standardet për ndërtimin e depos së plehut të stallës dhe përdorimin e plehut të stallës për plehërim.



Me qëllim të shkëmbimit të përvojave, IADK ka organizuar një vizitë studimore në Francë ku kanë marrë pjesë një përfaqësues nga organizata e IADK-së, një përfaqësues nga Shoqata Prodhuese e Qumështit dhe një fermerë prodhues i qumështit. Qëllimi i vizitës ka qenë në shkëmbimin e përvojave në sektorin e bujqësisë më konkretisht në organizimin e shërbimeve këshillimore, organizimin e fermerëve, trajnimin fermerëve në sektorin e prodhimit të qumështit dhe kontrollin e cilësisë së qumështit. Gjatë vizitës studimore janë realizuar shumë takime të ndryshme si me Odat e bujqësisë, institute të cilat merren me hulumtime, qendrat trajnuese për fermerët e rinj, shkolla të mesme bujqësore nga sektori privat dhe shtetëror, disa qendra hulumtuese dhe informuese për fermerët, ferma për prodhimin e qumështit.

## **PËRGATITJA E PROJEKT-PROPOZIMEVE DHE BIZNES PLANEVE**

Gjatë vitit 2015, IADK ka përgatitur projekte të ndryshme për fermer dhe kompani të interesuara për aplikim të donatorë të ndryshëm. Po ashtu fermerët janë përkrahur me këshilla direkte varësisht nga kërkesat e fermerëve. Gjithsej janë përgatitur 10 projekt propozime për grante të ndryshme.

## **PUBLIKIMET**

Gjatë vitit 2015 IADK ka përgatitur dhe publikuar 5 broshura dhe 11 fletëpalosje në të gjithë sektorët e bujqësisë. Broshurat dhe fletëpalosjet janë përgatitur në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht.



## LISTA E BROSHURAVE TË PUBLIKUARA

	<b>Titulli i publikimit</b>	<b>Sektori</b>	<b>Donatori</b>
1	Raporti vjetor IADK 2014	IADK	IADK
2	Kultivimi i mjedrës	Hortikultura	UNDP
3	Kompostimi	Hortikultura	BfW
4	Kultivimi i mjedrës	Hortikultura	Helvetas

## LISTA E FLETËPALOSJEVE TË PUBLIKUARA

	<b>Titulli i publikimit</b>	<b>Sektori</b>	<b>Dontatori</b>
1	Përmirësimi i kualitetit të qumështit	Blegtori	Canada Fund for Local Initiatives
2	Menaxhimi i plehut të stallës	Blegtori	BfW
3	Prodhimtaria organike e mjaltit	Blegtori	BfW
4	Kostoja e prodhimit të mjedrave organike	Hortikultura	BfW
5	Përmirësimi i kualitetit të qumështit	Blegtori	AKT/USAID
6	Të ushqyerit e lopëve qumështore	Blegtori	AKT/USAID
7	Hapat e përgatitjes së djathit	Përpunim Ushqimi	AKT/USAID
8	Gratë e veja krijojnë bufe në shkolla	Përpunim Ushqimi	EU
9	Pesë bufetë e krijuara në shkolla	Përpunim Ushqimi	EU
10	Përgatitja e ushqimit në bufe - Shkolla e Drenasit	Përpunim Ushqimi	BfW
11	Përgatitja e ushqimit në bufe - Shkolla Vushtrri	Përpunim Ushqimi	BfW
12	Rigoni i bardhë	Hortikultura	UNDP

### VIZITAT E STAFIT DHE VIZITAT ME FERMER GJATË VITIT 2015

Nr.	Vendi	Datat	Nr.i i ditëve	Nr.i Pjesëmarrësve	Sektori
1	Kosovë	11.02.2015	1	30	Përpunim Ushqimi
2	Kosovë	24.04.2015	1	14	Hortikulturë
3	Kosovë	27.04.2015	1	9	Hortikulturë
4	Kosovë	30.04.2015	1	13	Hortikulturë
5	Kosovë	20.05.2015	1	12	Hortikulturë
6	Kosovë	04.06.2015	1	12	Blegtori
7	Maqedoni	24-26.02.2015	2	2	Përpunim Ushqimi
8	Serbi	27.02.2015	1	2	Hortikulturë
9	Serbi	11-12.05.2015	2	40	Hortikulturë
10	Serbi	28-29.05.2015	2	24	Hortikulturë
11	Bullgari	20-24.10.2015	4	1	Menaxhment
12	Francë	22-30.11.2015	8	4	Menaxhment
Totali			<b>25</b>	<b>163</b>	

## LISTA E STAFIT TË IADK PËR VITIN 2015

NR.	EMRI MBIEMRI	DEPARTAMENTI	TITULLI I VENDIT TË PUNËS
1	ZENEL BUNJAKU	Menaxhment	Drejtor Ekzekutiv
2	GURSEL ARIFI	Blegtori	Udhëheqës i departamentit të Blegtorisë
3	XHAVIT SHALA	Blegtori	Inxhinier i Blegtorisë
4	MAGBULE HYSENI	Përpunim	Menaxhere e projektit
5	HAFIZE VESELI SYLEJMANI	Përpunim	Inxhinier e Përpunimit të ushqimit
6	BASRI HYSENI	Hortikulturë	Udhëheqës i departamentit të Hortikulturës
7	SYLEJMAN BUNJAKU	Hortikulturë	Inxhinier i lartë i Perimtarisë
8	SKENDER FEJZULLAHU	Hortikulturë	Inxhinier i Pemëtarisë
9	ESMA AZEMI KEPUZI	Financa, Administratë	Udhëheqëse e departamentit të Financave dhe Administratës
10	ARIANA PECI	Financa, Administratë	Zyrtare për Prokurim dhe Administratë
11	ELHEME SHALA	Financa, Administratë	Asistente e Financave
12	HANUMSHAHE ZENELI	Përpunim	Asistente e Zyrës
13	PETRIT KOCI	IT/Administratë	Mirëmbajtës i rrjetit/sistemit
14	FEHMI BASHOLLI		Kujdestar i objektit
15	SADETE MAHOLLI	Hortikulturë	Agronome
16	BLERINA REXHEPI	Hortikulturë	Agronome
17	GENTIANA BERISHA	Hortikulturë	Agronome
18	MIRJETA RRUSTEMI	Hortikulturë	Agronome
19	BLERINA REXHEPI	Hortikulturë	Eksperte - FADN
20	ANITA AVDULLAHU		Asistente fushore
21	EDLIRA PLLANA	Administratë	Eksperte-krijimi i data bazës
22	MIMOZA ISTREFI	Administratë	Eksperte-krijimi i data bazës


### **LISTA E PRAKTIKANTËVE NË VITIN 2015**

<b>NR.</b>	<b>EMRI MBIEMRI</b>	<b>DEPARTMENTI</b>
1	LABRION MAXHERA	Financa
2	BESMIRE ALIU	Financa
3	FATIME KADRIA NEZIRI	Hortikulturë
4	FILLORETE NISHORI	Hortikulturë

## TË HYRAT E IADK-SË NGA DONATORËT PËR VITIN 2015

Nr.	Emri i Donatorit/Partnerit	Emri dhe Kohëzgjatja e Projektit	Shuma €	Përqindja %
1	Zyra e Komisionit Europian në Kosovë	Fuqizimi Ekonomik dhe ndërtimi i kapaciteteve të grave të veja në regjionin e Mitrovicës/Mitrovica dhe Prishtinës/Priština	143,312	32.8%
2	Zyra e Komisionit Europian në Kosovë	Turizmi rural për zhvillimin ekonomik të zonës ndërkufitare të Kosovës dhe Malit të Zi	289	0.1%
3	Bread for the World	Gjenerimi i të ardhurave dhe aktivitet trajnuese për grupet e marginalizuara dhe fermerët në zonat rurale	61,493	14.1%
	Komunat (Vushtri, Mitrovicë, Drenas), Fermerët		11,383	2.6%
4	UNDP	Fuqizimi i kapaciteteve të fermerëve në Hortikulturë në Veri dhe Jug të Kosovës	200,544	45.9%
5	UNDP	Mbështetja e prodhimit vendor në Rajonin e komunave veriore në Mitrovicë dhe rajoni Ekonomik Jug	3,179	0.7%
6	Ambasada Kanadeze	Fuqizimi i grave në sektorin e bujqësisë dhe krijimi i lidhjeve të tregut	14,047	3.2%
7	MBPZHR	Promovimi i kultivimit të mjedrës, dredhëzes dhe permirësimit i kualitetit të qumështit	3,100	0.7%
	<b>Gjithsej</b>		<b>437,348</b>	<b>100%</b>


*Koment: Të gjitha të hyrat e paraqitura janë të hyra që janë njohur gjatë vitit 2015, përfshirë edhe të hyrat e shtyera nga viti 2014*





## TË HYRAT E IADK-SË NGA PARTNERËT PËR VITIN 2015

Nr.	Emri i Donatorit/ Partnerit	Emri dhe Kohëzgjatja e Projektit	Shuma €	Përqindja %
1	USAID/Chemoniks	Avansojmë Kosovën së bashku	23,292	27.2%
2	ARDP	Ofrimi i shërbimeve të grumbullimit të të dhënave primare për ex post vlerësimin e MBPZHR 2007-2013 të Kosovës	8,000	9.3%
3	Komuna e Drenasit	Bashkëfinancim dhe shërbime këshillimore për projekte për fermerë të Komunës së Drenasit	14,106	16.5%
4	Komuna e Mitrovicës	Bashkëfinancim për projekte për fermerë të Komunës së Mitrovicës	4,054	4.7%
5	Komuna e Vushtrrisë	Bashkëfinancim dhe shërbime këshillimore për projekte për fermerë të Komunës së Vushtrrisë	10,549	12.3%
6	Nëna Terezë	Trajnime në Blegtori	4,170	4.9%
7	SWISS	Vlerësimi i entiteve të përfshira në përpunimin e frutave dhe perimeve në kapacitete të vogla	5,687	6.6%
8	LAB	Ngritja e kapaciteteve të organizatës LAB dhe trajnime për fermerë	6,882	8.0%
9	AFDI	Viziat studimore të fermerëve në France	1,000	1.2%
10	PUM	Ekspertizë nga ekspertë të Holandës	1,600	1.9%
11	Të hyrat tjera	Të hyrat e ndryshme për shërbime të fermerëve, kompanive, qera etj...	6,383	7.4%
	<b>Gjithsej</b>		<b>85,723</b>	<b>100%</b>





Adresa:  
Fshati Sfarëqak i Ulët, p.n  
42000 Vushtrri  
Kosovë/a

*Të jetojmë nga toka dhe puna jonë!  
Let us live from our land and work!*

E-mail: [info@iadk.org](mailto:info@iadk.org)  
Tel/Fax: +381 (0) 28 536 726  
Web: [www.iadk.org](http://www.iadk.org)